



fq. 2 Kuvendi i Shqipërisë miraton tre anëtarë të Bordit të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare



*A.M.F. uron
Gëzuar Vitin 2015!*

VËSHTRIM MBI TREGJET

» Zhvillimet e Tregut të Sigurimeve në Shqipëri për periudhën janar-nëntor 2014

fq. 2-3

ZHVILLIME TË TJERA

» Mbledhje e Komitetit Rajonal Evropian të IOSCO-s, (*ERC Meeting*)

fq. 4

» Seminar mbi vlerësimin e modeleve të brendshme

fq. 5

LAJMET NGA RAJONI

» Bullgari » Greqi » Qipro » Hungari

fq. 6-8

Mbrojmë Konsumatorët - Promovojmë Tregjet - Zbatojmë Ligjin

Kuvendi i Shqipërisë miraton tre anëtarë të Bordit të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare

Kuvendi i Shqipërisë miratoi, në seancë plenare, më 24 dhjetor, tri kandidaturat për anëtarë të Bordit të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare (AMF).

Me shumicë votash u miratuan Znj. Enkeleda Shehi, Znj. Mimoza Kaçi dhe Z. Arjan Salati si anëtarë të Bordit të AMF-së. Znj. Enkeleda Shehi, propozim i Këshillit të Ministrave, do të mbajë postin e Drejtorit të Përgjithshëm Ekzekutiv. Znj. Mimoza Kaçi, propozim i Ministrisë së Financave, do të mbajë postin e Nëndrejtorit Ekzekutiv.

Më parë, ky miratim ishte dhënë edhe nga Komisioni për Ekonominë dhe Financat i Kuvendit, i cili zhvilloi një seancë dëgjimore me kandidaturat për drejtor dhe nëndrejtor ekzekutiv të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare.

VËSHTRIM MBI TREGJET

Zhvillimet e Tregut të Sigurimeve në Shqipëri për periudhën janar-nëntor 2014

Tregu i sigurimeve u rrit me 36.93% gjatë periudhës janar-nëntor 2014. Vlera e primeve të shkruara bruto në këtë periudhë arriti rreth 10.44 miliardë lekë. Kjo u shoqërua me rritje të numrit të policave të sigurimit me 2.57% duke arritur në 922,761 polica.

Një tjetër tregues i ecurisë së tregut, dëmet e paguara bruto, në total, regjistruan një rritje me 6.43% në krahasim me periudhën janar-nëntor 2013. Pjesa më e madhe dëmeve të paguara bruto i përket sigurimit motorik me rreth 2.08 miliardë lekë, apo 81.69% të totalit të dëmeve të paguara bruto.

Sigurimi i Jo-Jetës

Sigurimi i Jo-Jetës u rrit me 40.85% gjatë periudhës janar-nëntor 2014, krahasuar kjo me të njëjtën periudhë e një viti më parë.

Sigurimi i detyrueshëm motorik

Primet e sigurimit të detyrueshëm motorik vlerësohet të kenë arritur vlerën rreth 6.13 miliardë lekë gjatë periudhës janar-nëntor 2014, duke shënuar një rritje prej 82.90% krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar.

Sigurimi i detyrueshëm motorik gjatë periudhës raportuese përbën 58.85% të tregut të sigurimeve.

Klasa të tjera në sigurimet e Jo-Jetës

Ndër klasat e tjera kryesore të sigurimit të Jo-Jetës veçohen:


- » Zjarri, forcat e natyrës dhe dëmtime të tjera në pronë të cilat zunë 16.21% të tregut të Jo-Jetës;
- » Sigurimi i aksidenteve, sigurimi i shëndetit dhe sigurimi i përgjegjësive të përgjithshme, të cilat së bashku zunë 11.50% të tregut të Jo-Jetës.

Sigurimi i Jetës

Primet e shkruara bruto në sigurimin i Jetës u rritën me 5.59% krahasuar me periudhën janar-nëntor të vitit 2013. Pjesa më e madhe e primeve të shkruara bruto i përket sigurimit “Jetë debitor” e cila përbën 60.01% të sigurimit të Jetës.

Ndarja e tregut të sigurimeve, janar-nëntor 2014

Grafiku më poshtë paraqet ndarjen e volumit total të primeve të shkruara bruto sipas grupeve kryesore.



ZHVILLIME TË TJERA

Mbledhje e Komitetit Rajonal Evropian të IOSCO-s, (ERC Meeting)

Organizata Ndërkombëtare e Komisioneve të Letrave me Vlerë, (*International Organization of Securities Commissions, IOSCO*) në bashkëpunim me Autoritetin e Tregjeve dhe Shërbimeve Financiare të Belgjikës (*Financial Services and Markets Authority of Belgium*), zhvilluan në datat 11-12 dhjetor 2014, në Bruksel, mbledhjen e radhës së Komitetit Evropian të IOSCO-s (*ERC Meeting*). Kryetari i FSMA-së të Belgjikës, Jean-Paul Servais, është i sapozgjedhur në krye të ERC-së.

AMF është anëtare e njërit prej këtyre komiteteve, të cilat mbledhen rregullisht për të diskutuar për problemet në tregjet që ata mbikëqyrin. Në strukturën e IOSCO-s funksionojnë katër komitete të tilla të specializuara sipas rajoneve.

Sekretariati i IOSCO-s prezantoi raportin konsultativ që grupi i punës ka përgatitur mbi drejtimin strategjik të IOSCO-s për vitet 2015-2020. Ky drejtim synon të vendosë prioritetet e IOSCO-s deri në 2020, propozon planet e veprimit dhe identifikon burimet e nevojshme për t'i përmbushur ato. Mbi këtë raport, u zhvilluan diskutime nga anëtarët e propozime për hartimin e dokumentit përfundimtar.

Me rëndësi ishin informacionet nga anëtarët mbi zhvillimet dhe sfidat në tregjet që ato rregullojnë në juridiksionin e tyre. Tematikat e tjera të diskutuara lidheshin edhe me:

- » Prezantimin nga raporti i ESMA-së (*European Securities and Markets Authority*) për aktivitetet e saj;
- » Prezantimin nga Komisioni i Tregut të Kapitaleve të Greqisë (HCMC) rreth *Stress-Test* që analizojnë rreziqet potenciale në integritetin e tregjeve;
- » Raportin nga FSMA e Belgjikës mbi iniciativat e fundit të mbrojtjes konsumatore;
- » Programin e Komisionerit të Bashkimit Evropian për stabilitetin financiar, shërbimet dhe tregun e kapitalit.

Në vazhdim të takimit u diskutuan edhe çështje të tjera organizative të IOSCO-s.

Seminar mbi vlerësimin e modeleve të brendshme

Iniciativa për Trajnimet në Mbikëqyrjen Financiare (TIFS) në bashkëpunim me Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare të Polonisë (PFSA) zhvilluan në datat 10-12 dhjetor në Varshavë seminarin “Vlerësimi i modeleve të brendshme: Qasje sasiore dhe cilësore”. Në këtë seminar merrnin pjesë aktuarë, ekspertë dhe drejtues të autoriteteve mbikëqyrëse në tregun e sigurimeve nga vende si: Azerbajxhani, Bosnje-Hercegovina, Republika Çeke, Danimarka, Finlanda, Hungaria, Lituania, Norvegjia, Sllovenia, Turqia, si dhe përfaqësues nga Autoriteti i Polonisë. Lektorë dhe prezantues në seminar ishin përfaqësues nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare të Polonisë, konsulentë të tregut të sigurimeve në Poloni, si dhe ekspertë nga Britania e Madhe. Seminari u fokusua kryesisht në përdorimin e teknikave dhe mjeteve mbikëqyrëse në analizën e supozimeve kryesore dhe kufizimeve të modeleve të rrezikut.



Përfaqësuesit e seminarit mbi vlerësimin e modeleve të brendshme

Gjatë seminarit u diskutua aplikimi i modeleve të brendshme në sistemin e vlerësimit të rrezikut sipas kërkesave të *Solvency II*. Ekspertë nga Autoriteti Polak prezantuan aplikimin e kësaj skeme në Poloni, duke nisur që nga puna paraprake që është bërë përgjatë vitit 2014 dhe proceset e tjera në vazhdimësi për realizimin e afateve përfundimtare në zbatimin e skemës së modeleve të brendshme. Ata nënvizuan edhe rezultat e pritshme nga aplikimi i kësaj skeme në tregun e sigurimit.

Temat kryesore që u trajtuan në këtë seminar ishin:

- » Modelet e brendshme të vlerësimit të rrezikut, ku u trajtua eksperiencia e Polonisë në këtë drejtim;
- » Standardizimi i modeleve të brendshme për shoqëritë e sigurimit të Jo-Jetës;
- » Raste studimore mbi vlerësimin e modeleve të rrezikut në tregun e sigurimeve;
- » Aftësia Paguese II (*Solvency II*)-përdorimi i modeleve të brendshme në procesin e vendimmarrjes;
- » Sfidat e paraqitura lidhur me vlerësimin e modeleve të brendshme për kompanitë e sigurimit vendase, të cilat janë anëtarë të grupeve.

Në vazhdimësi u bënë prezantime të rasteve që i ndihmuan pjesëmarrësit të bashkëvepronin me ekspertët dhe të merrnin përvojën e vendeve të ndryshme. Rastet studimore kryesisht lidheshin me mundësinë e ekspozimit ndaj rrezikut të tregut të kompanive të sigurimit (*Market risk exposure of the insurance companies*). Edhe përfaqësues nga industria e sigurimeve shpjeguan sfidat e tyre në realizimin praktik të modeleve të brendshme sipas *Solvency II*.

LAJMET NGA RAJONI

BULLGARI

www.xprimm.com

Siguruesit bullgarë regjistruan një normë vjetore të rritjes së primeve të shkruara bruto prej 4.76% gjatë nëntëmujorit të 2014 krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar, duke arritur një total të vëllimit të primeve të shkruara bruto prej 658.4 milionë euro. Në të njëjtën kohë, dëmet e paguara bruto u rritën me 10.4%, duke arritur në 343.98 milionë euro, pjesërisht si pasojë e ngjarjeve ekstreme të motit të regjistruar gjatë verës.

Primet e shkruara bruto në sigurimin e Jetës u rritën me 8.3% duke arritur në 125 milionë euro. Rritja e volumit të primeve të shkruara bruto u shoqërua edhe me një rritje të ndjeshme në dëmet e paguara bruto për sigurimin e Jetës.

Primet e shkruara bruto në sigurimin e Jo-Jetës u rritën me rreth 4%, duke arritur në 533.4 milionë euro. Pjesa më e madhe e kësaj rritje vjen nga sigurimet motorike me rreth 60% krahasuar me nëntëmujorin e vitit 2013.

Rritja në volumin e primeve të shkruara bruto të Jo-Jetës është shoqëruar me rritje në vëllimin e dëmeve të paguara bruto (20.87 milionë euro), kryesisht nga dëmet e shkaktuara nga ngjarjet ekstreme të motit, të ndodhura gjatë verës. Sigurimi Kasko u rrit me 13 milionë euro, ndërsa sigurimi nga zjarri dhe rreziqet shtesë u rrit në më shumë se 8 milionë euro.

GREQI

www.xprimm.com

Sipas një raporti të publikuar nga Shoqata Greke e Kompanive të Sigurimit (HAIC), siguruesit grekë raportuan një vlerë prej 2.8 miliardë euro të primeve të shkruara bruto në nëntëmujorin e 2014, me një rënie prej 1% krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar. Raporti përfshin të dhëna nga 59 sigurues, që përfaqësojnë 94.4% të volumit të primeve të shkruara bruto të tregut. Nga këto, 21 sigurues veprojnë në sigurimin e Jetës dhe 48 në sigurimin e Jo-Jetës.

Gjatë kësaj periudhe, primet e sigurimit të Jo-Jetës arritën në vlerën 1.5 miliardë euro, ose 10% më pak krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar. Shkak për këtë është rënia pothuajse në të gjitha segmentet e Jo-Jetës: Sigurimi Kasko (-13.4%), dëmet ndaj pronës (-10.6%), sigurimi TPL (-13.4%), zjarri dhe rreziqet shtesë (-7.8%), Kartoni Jeshil (-2.9%).

Tregu i sigurimit të Jetës u rrit rreth 11.8% duke arritur në 1.3 miliardë euro. Policat tradicionale të sigurimit të Jetës u rritën me 1% dhe sollën rreth një të tretën e totalit të primeve të tregut, ndërsa produktet e lidhura me investimet, patën rritje shumë më të madhe.

QIPRO

www.xprimm.com

Sipas raportit të Shoqatës së Sigurimeve të Qipros (IAC), në fund të shtatorit 2014, tregu i sigurimeve të Qipros arriti në 549 milionë euro ose 3.9% më pak krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar. Rënie më të madhe të primeve të shkruara bruto është raportuar në sigurimin e Jetës, nga 243 milionë euro në 227 milionë euro (ose 6.4% më pak krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit kaluar). Ndërsa sigurimi i Jo-Jetës u ul me 2.1% krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit kaluar, duke arritur në 321 milionë euro.

Në të njëjtën kohë, vlera e dëmeve të paguara bruto nga siguruesit ra me 30%, duke arritur në 339 milionë euro. Shkak i kësaj rënie ishte kryesisht rënia e dëmeve të paguara në sigurimin e Jetës.

HUNGARI

www.xprimm.com

Sipas të dhënave të publikuara nga Banka Kombëtare e Hungarisë (MNB) dhe shoqata e siguruesve hungarezë (MABISZ), në nëntëmujorin e 2014, siguruesit hungarezë raportuan vëllimin e primeve të shkruara bruto prej 2.03 miliardë euro. Tregu i sigurimit të Jetës regjistroi një rritje rreth 3.4%, të volumit të primeve të shkruara bruto.

Në tregun e sigurimeve të Jo-Jetës, primet e shkruar bruto u rritën 3.27%, në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar, duke arritur në vlerën 0.93 miliardë euro. Sigurimi motorik, sidomos klasa e sigurimit MTPL, ka pasur rolin më të madh në rritjen e volumit të primeve të shkruara bruto, me një normë të rritjes vjetore 5.04%. Numri i përgjithshëm i policave MTPL të shitura arriti në 151,256 njësi më shumë krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar.

Sigurimi i pronës shënoi një rënie 0.54% në volumin e primeve si rezultat i ndryshimit negativ regjistruar për linjën zjarri dhe rreziqet shtesë, e cila pati një rënie të numrit të përgjithshëm të policave të shitura me rreth 10,000 njësi duke çuar në rënie të primeve të shkruara bruto me 3.47%.

Dëmet e paguara gjatë nëntëmujorit të vitit 2014 patën një periudhë qetësie, larg ngjarjeve të mëdha të motit. Kështu, dëmet e paguara u ulën me rreth 12% krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar, duke ndihmuar siguruesit hungarezë për të ruajtur ekuilibrin financiar.